


DORACAK PËR TIK

METAMORPHOSIS Nr. 5



SIGURTË NË INTERNET

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET: SI MUND TË RRRITURIT T'I NDIHMOJNË FËMIJËT NË MBROJTJEN NGA RREZIQET POTENCIALE TË INTERNETIT, DERISA NJËKOHËSISHT U TREGOJNË PËR PËRMBAJTJET DHE SHËRBIMET QË MUND TË JENË TË DOBISHME?

Fëmijët dhe adoleshentët e përdorin internetin për gjithçka. Shpesh, interneti është vend i dobishëm për ta, falë të cilit ata fitojnë aftësi, përvoja dhe njohuri të reja, por njëkohësisht ekzistojnë edhe rreziqe reale që mund të ndikojnë në privatësinë dhe sigurinë vetjake të tyre, madje mund ta vënë në pyetje sigurinë e gjithë familjes. Derisa janë në internet, fëmijët tuaj mund të hasin në informata apo fotografi shqetësuese, në mënyrë naive të pranojnë apo shkëmbejnë fajl që mund ta vënë në rrezik të gjithë familjen prej vjedhësve-sajber apo ta infektojnë kompjuterin me viruse. Ata mund të hasin në **dhunues-sajber (cyberbullies)** të cilët do të përpiqen t'i trembin apo turpërojnë. Edhe më keq, fëmijët tuaj, pa ditur, mund të komunikojnë me **rrëmbyes online (online predators)**, të cilët e përdorin internetin për të vendosur marrëdhënie shoqërore me fëmijë të lëndueshëm, hiqen se janë moshatarë të tyre apo ndonjë i rritur tek i cili mund të kenë besim, e më vonë përpiqen t'i bindin që të takohen drejtpërdrejt.

Nuk ka dyshim se ka rreziqe nga përdorimi i internetit, sidomos për fëmijët, por është e gabim që për shkak të kësaj t'ua ndaloni qasjen te të gjitha përmbajtjet dhe mundësitë që i ofron ai. Në këtë mënyrë nuk do t'i mbrojmë ata, sepse fëmijët përdorin internet në vende të ndryshme: në shtëpi, në shkollë, te shokët etj., kështu që është e pamundur vazhdimisht të kenë kontroll mbi ta, e çështje më e keqja, do t'ua shkurtoni mundësinë të mësojnë dhe të hulumtojnë shumë gjëra dhe të fitojnë përvoja të reja, të cilat nuk do të mund t'i përjetonin nëpërmjet asnjë mediumi tjetër. Duhet të vendosni raport miqësor dhe korrekt me fëmijët tuaj, t'ua shpjegoni gjërat për të cilat duhet të kenë kujdes gjersa janë online, dhe të ndërmerri masa të caktuara deri në atë shkallë e cila nuk ka do ta dëmtojë privatësinë e tyre, lirinë dhe të drejtën e përzgjedhjes. Balansin e vërtetë në mes të masave që do t'i ndërmerri dhe privatësisë, të drejtave dhe lirive të fëmijëve tuaj, mund ta caktoni vetëm ju, edhe atë në përputhje me moshën e tyre, kushtet dhe vetë fëmijët.



Doracak për përdorim të sigurt të internetit nga fëmijët, i dedikuar për prindërit dhe arsimtarët

Ky doracak përmban informata, këshilla dhe udhëzime konkrete të cilat do t'u ndihmojnë prindërve të sigurojnë mbrojtje më të madhe të fëmijëve të tyre derisa ata e shfrytëzojnë internetin. Njëkohësisht, ky doracak u dedikohet arsimtarëve të cilët gjithashtu ndikojnë mbi shprehitë, njohuritë dhe qëndrimet e fëmijëve. Ai përmban dhe rregulla konkrete që duhet t'i mësojnë dhe respektojnë fëmijët dhe adoleshentët. Doracaku paraqet edhe një burim të pasur informatash që mund të jenë të dobishme për gazetarët dhe mediat gjatë hulumtimeve të tyre. Këtë botim, si dhe të gjithë doracakët e deritanishëm të cilët i ka botuar Metamorfozis, mund t'i gjeni në formë elektronike në ueb-sajtin e fondacionit: www.metamorphosis.org.mk. Për versionet e botuara, shkruani në: info@metamorphosis.org.mk

Shpesh, fëmijët shumë më mirë i kuptojnë mundësitë që ua ofrojnë teknologjitë bashkëkohore dhe interneti sesa prindërit e vet. Prandaj, që të mund t'u ndihmoni fëmijëve tuaj në zhvillimin e shprehive të mira të internetit, së pari duhet të njiheni me termat themelore që kanë të bëjnë me përdorimin e internetit, si dhe me aktivitetet me të cilat merren ata gjersa janë online. Ky është hapi i parë që duhet ta ndërmerri për mbrojtje më të madhe të fëmijëve tuaj gjersa ata shfrytëzojnë internetin.

Para se dhe vetë t'i ndani rreziqet e internetit prej dobive të tij, së pari duhet të njiheni me disa nocione të cilat i përshkruajnë karakteristikat e tij, shërbimet, mundësitë e tjera etj.

20 nocionet e mëposhtme janë nocione themelore dhe të obligueshme:

- **interneti** – rrjet i shtrirë në mbarë botën i kompjuterëve të cilët mundësojnë qasje të lehtë te një numër i madh informatash, që u mundëson njerëzve t'i gjejnë dhe t'i shfrytëzojnë ato informata, si dhe të komunikojmë në mes vete.
- **World Wide Web (WWW, ueb)** – shërbim i internetit që ofron numër të pakufizuar të ueb-sajteve, lojëra, fotografi, tinguj, përralla dhe informata të tjera që lidhen ndërmjet tyre nëpërmjet linqeve.
- **Web page (ueb-faqe)** – një dokument i uebit që ka adresë unike apo URL
- **Website (ueb-sajt)** – grup ueb-faqesh të ngjashme të lidhura nëpërmjet linqeve, të menaxhuara nga një kompani, organizatë apo individ.
- **Adresa** – lokacion unik i çdo ueb-faqeje, ueb-sajti, fajli apo shfrytëzuesit të e-mailit.
- **Browser (shfletues)** – program kompjuterik që mundëson vëzhgim të ueb-faqeve. Shfletues më të njohur janë Internet Explorer, Mozilla Firefox, Opera e të tjerë.
- **Browsing (shfletim)** – shikim i ueb-faqeve të internetit, kalim nga një faqe në tjetrën. Përdoren dhe termat surfim, navigim.
- **Links, hyperlinks (linqe, hiperlinqe, lidhje, hiperlidhje)** – fotografi apo pjesë teksti, të cilat kur do të klikohet mbi to, mundësojnë lidhje elektronike me përmbajtje të tjera si: fotografi, tinguj, animacione, video apo ueb-faqe të tjera.
- **Bookmark, favorite (shënues, favorit)** – lidhje e ruajtur e një ueb-sajti apo ueb-faqe që shtohet në një listë të veçantë të lidhjeve të ruajtura në shfletues. Falë lidhjeve të ruajtura në këtë mënyrë, faqet e vizituara njëherë, më vonë mund t'i hapni lehtë pa pasur nevojë që t'i shkruani adresat e tyre nga fillimi.
- **Search engine (kërkues)** – program i cili kërkon informata në ueb, në bazë të fjalëve kyçe që i fusin shfrytëzuesit dhe pastaj kthen listë të ueb-faqeve që kanë lidhje me temën e dhënë. Kërkuesit më të njohur janë Google, Yahoo, MSN Search etj.
- **Download (shkarkim)** – kopjim dhe inçizim i fajleve në kompjuterin tuaj. Mund të merren ueb-faqe, dokumente, fotografi etj.
- **E-mail (Electronic Mail)** – Posta elektronike apo e-maili është sistem për dërgim të mesazheve në mënyrë elektronike nga një kompjuter në tjetër. Mesazhet elektronike mund të dërgohen dhe të pranohen për disa sekonda, prandaj paraqesin mënyrë më të përshtatshme për këmbim të postës në krahasim me mënyrën tradicionale të telegrafit, postës ordinare.
- **SPAM** – e-mail i padëshiruar apo e-mail i pranuar pa kërkesë të specifikuar nga pranuesi.
- **Chat room (dhoma për bisedë)** – vend në internet që mundëson komunikim me njerëz të tjerë në internet në kohë reale, përkatësisht drejtpërdrejt. Dhomat për bisedë në internet janë shumë populizuara në mesin e adoleshentëve dhe fëmijëve.
- **Real time (në kohë reale)** – komunikim nëpërmjet internetit në të njëjtën kohë, në mënyrë simultane.
- **Bllogu** është ditar online i cili mund të përmbajë fotografi, linqe dhe komente të vizitorëve.
- **Social Networking Site (sajt për rrjetëzim social)** – ofron mundësi për krijim të faqeve personale sipas një procedure të thjeshtë, të cilat paraqesin profile publike të shfrytëzuesve, nëpërmjet të cilave ata njihen me njëri tjetrin, shkëmbejnë fotografi, interesa etj. Sajtet e tilla kanë numër të madh shfrytëzuesish, kurse pjesa më e madhe e tyre janë fëmijë dhe adoleshentë. Sajtet më të njohura për rrjetëzim social janë Hi5, Facebook, My Space etj..
- **Forumi** – ueb-sajt në të cilin njerëzit mblidhen që të shkëmbejnë informata për tema të ndryshme.
- **Shërbim për mesazhe instant (IM – Instant messaging)** – shërben për dërgim dhe pranim të mesazheve nëpërmjet internetit, "në kohë reale", duke shfrytëzuar softuer për atë qëllim. Softuerët më të njohur janë: ICQ, Skype, GoogleTalk, MSN Messenger, Yahoo!Messenger etj.



Cilat janë anët e mira të internetit?

Interneti ofron mundësi, si për të rriturit, ashtu dhe për fëmijët dhe adoleshentët. Edhe pse ka shumë anë të mira, në përgjithësi ato mund të grupohen në këto karakteristika:

Qasje e lehtë në shumë informata	Blerje
Komunikim i shpejtë pa marrë parasysh largësinë	Lexim lajmesh
Mundësi të pakufizuara për hulumtim	Lojëra
Kryerje të transaksioneve bankare dhe financiare	Reklamim

Çfarë bëjnë fëmijët në internet:

- **komunikojnë** me fëmijë të tjerë
- vizitojnë ueb-sajte me **përmbajtje argëtuese**
- e shfrytëzojnë si **burim informatash** për projektet shkollore dhe për detyrat e shtëpisë.

Edhe pse dobite e tij i tejkalojnë rreziqet e tij, megjithatë në internet ekzistojnë edhe rreziqe.

Ato dalin nga këto karakteristika të internetit:

- **mundëson anonimitet** – çdokush mund ta fshehtë identitetin e vet në internet
- **nuk ka kufizim për përmbajtjet që mund dhe lejohen të shpallen**
 - përmbajtje joadekuate për fëmijë:
 - pornografi dhe material tjetër seksual
 - fotografi të frikshme të personave të vrarë apo të lënduar rëndë
 - urrejtje
 - drogë
 - armë dhe dhunë
 - të dhëna të pasakta dhe irelevante

- **nuk ka as kufizim sa i përket përmbajtjeve të cilat mund t'i shpallin fëmijët**
 - duke shfrytëzuar programet për komunikim apo sajtet për rrjetëzim social, shumë lehtë zbulohen të dhënat personale të tyre, prandaj është i mundshëm dhe keqpërdorimi i tyre nga të tjerë.
- **ka hakerë dhe viruse**
 - funksionimi jo i mirë i sistemit, humbja e të dhënave, dëmtimi dhe shkatërrimi i tërësishëm i disa komponenteve të harduerit.
- **ka rreziqe ligjore dhe financiare**
 - shfrytëzim joligjor i përmbajtjeve të mbrojtura, keqpërdorim i mundësisë për kryerje të transaksioneve financiare etj.

Fakte statistikore nga bota

(sipas <http://www.familysafemedia.com> dhe burime tjera)

- Çdo i treti fëmijë në shoqërinë e informatikës ka bllogun apo ueb-sajtin e vet.
- Një hulumtim i kryer me adoleshentë nga mosha 15 deri në 24 vjet ka treguar se 59% e tyre mendojnë se shikimi i pornografisë në internet, i inkurajon të rinjtë të kenë seks para se të jenë të përgatitur për atë.
- 12% e të gjitha ueb-sajteve janë pornografike.
- 90% e fëmijëve nga mosha 8 deri në 16 vjet kanë parë pornografi në internet, edhe atë në të shumtën e rasteve rastësisht.
- Mosha mesatare kur fëmijët për herë të parë hasin pornografi në internet është 11 vjet.



Fakte statistikore nga bota

(sipas <http://www.familysafemedia.com> dhe burime tjera)

- Më shumë pornografi në internet konsumohet në moshën prej 12 deri në 17 vjet.
- Industria pornografike në internet tregon se 20-30% të qarkullimit në sajtet e tilla e realizojnë fëmijët.
- Në ditë dërgohen 2.5 miliarda mesazhe e-mail pornografikë.
- 26 emra të karaktereve për fëmijë (pokemon, ekshën men etj.) çojnë në mijëra porno sajte.
- 27% e fëmijëve prej moshës 7 deri në 17 vjet lirisht do ta jepnin adresën e vet të shtëpisë nëpërmjet internetit, kurse 14% - adresën e vet të e-mailit.
- 40% e adoleshentëve kanë lënë informacione personale në internet që të tjerët të mund t'i kontaktojnë.
- Një në pesë fëmijë që përdorin "dhoma për bisedë" janë kontaktuar nga pedofil onnline.
- Dy nga pesë kidnapime të viktimave prej 15 deri në 17 vjet kanë ndodhur si pasojë e përdorimit të internetit.
- 76% e rasteve të eksploatimit seksual të iniciuar nëpërmjet internetit kanë qenë fëmijë të moshës 13 deri në 15 vjet. 75% kanë qenë vajza. Shumica e rasteve kanë vazhduar me takim të drejtpërdrejtë, kurse në 93% të këtyre takimeve ka pasur seks të paligjshëm.
- Gjatë një viti, mesatarisht, një nga pesë fëmijë kanë marrë propozim seksual nëpërmjet internetit, kurse vetëm 25% e tyre u kanë treguar prindërve të vet për këtë gjë.
- 89% e të gjitha kërkesave seksuale janë realizuar nëpërmjet "dhomave për bisede" apo mesazheve instant.

Si është situata në Maqedoni?

Kohët e fundit, në Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale gjithnjë e më shpesh vijnë lajmërimet për keqpërdorim të të dhënave personale në internet, konkretisht nëpërmjet ueb-sajteve për rrjetëzim social (si Hi5, My Space, facebook etj.). Sipas të dhënave të fundit, 10% e kërkesave të marra prej qytetarëve kanë të bëjnë me keqpërdorim të të dhënave personale në internet. Megjithatë, numri real është shumë i madh në qoftë se merret parasysh se qytetarë çdo ditë telefonojnë në këtë Drejtori për të kërkuar këshilla dhe ndihmë në lidhje me këto punë.

Rasti që vijon flet për keqpërdorim të të dhënave personale të personave të rritur të shkaktuar dhe realizuar prej gjimnazistëve.

Kohët e fundit, është e shpeshtë dukuria e krijimit të profileve të rrejshme, përkatësisht ueb-faqeve personale në emër të huaj. Para do kohe, një shkolle e mesme nga Shkupi e informoi Drejtorinë se është kryer keqpërdorim i të dhënave personale të profesorëve në njërin nga ueb-sajtet për rrjetëzim social, me çka është dëmtuar personaliteti i tyre, por edhe autoriteti i shkollës. Secili prej profileve përmbante të dhëna personale, emër dhe mbiemër, të dhëna për gjininë dhe moshën, por edhe përmbajtje

të tjera ofenduese dhe fyese. Krijuesit kreativë kishin shkuar aq larg sa kishin shpallur edhe prezentime personale, dëshmi dhe fotografi të personave në emër të të cilëve i kishin krijuar profilet, dhe në të cilat ishin shpallur detaje të rrejshme për jetën private të anëtarëve të familjeve të profesorëve, si dhe informata të rrejshme për jetën e tyre profesionale. Në pjesën e ueb-sajtit të paraparë për komunikim të shrytëzuesve të regjistruar është botuar një bisedë e rrejshme midis profesorëve që kishte të bëjë me shtyerjen e testeve dhe pyetjes së nxënësve, përfshinte komunikim me nxënësit, por pjesa më e madhe e përmbajtjeve ishin shumë vulgare. Edhe pse bëhet fjalë për ueb-sajt të regjistruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Drejtoria nuk ka kompetenca të inicojë procedurë kundër këtij kontrollori, ajo si organ që e mbron privatësinë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, menjëherë kontaktoi ekipin e portalit dhe profilet e rrejshme u fshinë në afat prej disa orësh.

Lloji i këtillë i shkeljes së privatësisë së profesorëve nuk është dukuri vetëm në shkollat e mesme të Republikës së Maqedonisë. Shumë shpejt pas zbulimit të këtij rasti, Drejtoria u lajmërua se e njëjta gjë ka ndodhur edhe në



një shkollë tetëvjeçare. U rekomandohet të gjithëve që do të vërejnë shpallje të pasakta të të dhënave personale në ndonjë ueb-sajt për rrjetëzim social, që menjëherë ta lajmërojnë Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale që këto parregullsi të hiqen sa më shpejt që është e mundur. Drejtoria është në bashkëpunim të vazhdueshëm me ekipet e ueb-sajteve për rrjetëzim social, që mundëson zbulim të shpejtë dhe efektiv, dhe zgjidhje të problemeve që kanë të bëjnë me shkeljen e të dhënave personale. Megjithatë, më me rëndësi është që të gjithë ata që përdorin kësi lloj ueb-sajtesh, të kenë kujdes kur shpallin të dhëna personale, por dhe të huaja, në internet.

Fëmijët dhe adoleshentët shpesh janë viktimë të keqpërdorimeve të të dhënave personale. Ja një rast i paraqitur në Drejtori i cili flet për këtë gjë:

Keqpërdorimi më i shpeshtë i të dhënave personale të fëmijëve në internet ndodh nëpërmjet keqpërdorimit të emrave përdorues dhe fjalëkalimeve (*password*) të faqeve të tyre personale, të krijuara në ueb-faqet për rrjetëzim social. Në një nga rastet e paraqitura ishin zbuluar jo vetëm fjalëkalimi dhe emri përdorues për hyrje në profilin personal, por edhe fjalëkalimi për hyrje në postën elektronike personale, nëpërmjet e-mail adresës të cilën adoleshentja e kishte lënë për kontakt. Ishte zbuluar madje dhe përgjigja e pyetjes së fshehtë, që është çelës për hyrje në postën elektronike personale, në rast të harrimit të fjalëkalimit. Vjedhësi i emrave përdorues dhe fjalëkalimeve, kishte vendosur përmbajtje dhe fotografi vulgare në faqen personale të adoleshentes dhe në atë mënyrë seriozisht e shkeli privatësinë e saj.

Kuptojeni gjuhën online të fëmijëve dhe të adoleshentëve

Ndoshta ndonjëherë ju ka ndodhur të kaloni afër monitorit të kompjuterit përderisa fëmija juaj bisedon me ndonjë prej shokëve online të tij nëpërmjet programeve për bisedë apo për mesazhe instant, dhe shikimi rastësisht u ka mbetur te disa simbole dhe shkurtesa të pakuptueshme, për shkak të të cilave mund të dyshoni në shumë çështje. Nuk duhet ta hulumtoni në mënyrë të detajuar gjuhën me të cilën komunikojnë të rinjtë online, por është mirë t'i dini disa prej shprehjeve dhe simboleve kryesore. Kjo mund t'ju ndihmojë për dy çështje: mund ta përforcojë komunikimin tuaj të ndërsjellë nëpërmjet chat-it, SMS-it dhe e-mail-it dhe t'ju japë ide më të qartë për atë se çka bisedojnë ata me shokët online. Nuk do të thotë se kur përdorin simbole dhe shkurtesa se ata fshehin diçka, më shpesh duan vetëm ta ruajnë privatësinë e vet. Megjithatë ka dhe të tillë që direkt juve ju fusin në lojë. Si do që të jetë, është e pëlqyeshme t'i dini disa prej shkurtesave më të njohura, që t'i kuptoni më mirë aktivitetet online të fëmijës tuaj.

Ja disa prej tyre:

LOL - Laughing out loud – qeshem me zë të lartë
ROFL - Rolling on floor laughing – rrotullohem në dysheme nga të qeshurit
JK - Just kidding – po bëj vetëm shaka
AFK - Away from keyboard – larg tastierës
BAK - Back at keyboard – u ktheva te tastiera
BRB - Be right back – kthehem menjëherë
L8R - Later - më vonë
CUL (CUL8R) - See you later – shihemi më vonë
PRW - Parents are watching – prindërit po shohin
PIR - Parent in room – prindi në dhomë
ASAP - As soon as possible – sa më shpejt që është e mundur
MIRL - Meet in real life – të takohemi në jetën reale
F2F - Face to face – ballë për ballë
SYS - See you soon – shihemi së shpejti
OMG - Oh my God – O Zot
WTH - What the hell – çfarë drejtin do?
CD9 - Code 9: Parents nearby – prindi në afërsi
POS - Parent over shoulder – prindi po vështron pas shpine
IRL - In real life – në jetën reale
A/S/L - Age/Sex/Location – Moshë/gjinia/vendi

Shumica e shkurtesave të tilla janë të parrezikshme dhe të rinjtë duan t'i përdorin si pjesë e stilit të tyre të shprehjes, që është karakteristikë e tyre dhe e moshatarëve të tyre, por disa duhet t'i njihni mirë sepse drejtpërdrejt mund të ndikojnë në sigurinë e tyre. Për shembull, shkurtesa A/S/L është një ndër më të vjetrat dhe më të përdorurat, por sipas një ankete, prindërit më së paku e dinë kuptimin e saj (92% e të anketuarve). Me t'u shfaqur kjo shkurtesë në bisedë, duhet ta dini se fëmija juaj bisedon me një të panjohur dhe ka gjasa të mëdha të shkëmbejë shumë të dhëna personale me të. Nuk duhet ta ndaloni njohjen e shokëve online, por duhet të jeni të informuar për shoqëritë aktuale online të fëmijës tuaj, në rast se ai do të donte të takohet drejtpërdrejt me ndonjërin prej tyre.

Përveç shkurtesave, fëmijët, madje dhe më të rriturit, përdorin mjaft simbole me të cilat shprehin emocione të ndryshme që e shoqërojnë pjesën tekstuale të shkëmbimeve të mesazheve të shkurtra. Këto janë krejtësisht të parrezikshme,

por në qoftë se doni të afroheni më shumë me fëmijët tuaj, filloni t'i përdorni në komunikimin e ndërsjellë. Më shpesh nuk ka nevojë të dini si t'i shkruani që të shfaqet simboli i dëshiruar, sepse në shumicën e programeve për bisedë dhe shkëmbimin të mesazheve të shkurtra, si dhe në disa e-mail servise, ato janë të përfshira si elemente të gatshme grafike që vetëm duhet të përzgjidhen. Por, në qoftë se me fëmijët tuaj më shpesh komunikoni nëpërmjet mesazheve SMS, mos harroni të buzëqeshni :), të qeshni me zë të lartë :D, të zemëroheni >:(, apo të mbyllni syrin ;), gjithsesi në situatën dhe kontekstin përkatës.

Edhe një këshillë për prindërit të cilët nuk kanë shumë përvojë në komunikimin nëpërmjet internetit: kur përdoren online, shkronjat e mëdha do të thonë bërtitje, prandaj anashkalojeni përdorimin e tyre që të mos ju keqkuptojnë.

2

Hapi nr. 2 – Caktoni disa rregulla themelore

Fëmijët duhet të dinë në cilat kushte, në cilën periudhë dhe në cilën mënyrë mund ta përdorin internetin. Këto kushte përcaktoni ju. Filloni për shembull me atë se internetin mund ta përdorin vetëm pasi t'i kenë përfunduar obligimet shkollore.

3

Hapi nr. 3 – Kompjuteri në vend qendror

Vendoseni kompjuterin në vend qendror, në dhomë apo në klasë, që të mund të shikoni kohë pas kohe se ç'bëjnë fëmijët tuaj. Kjo është e rëndësishme që të vëreni në qoftë se fëmijët rastësisht hasin përmbajtje të cilat nuk korrespondojnë me moshën dhe interesat e tyre.

4

Hapi nr. 4 – Vendosni kufizim kohor

Fëmijëve nuk duhet t'u lejon të kalojnë më shumë se 1-2 orë në ditë para monitorit të kompjuterit. Për fëmijët deri në moshë 7 vjeçare, më mirë është të shfletoni së bashku me ta, ndërsa për fëmijët më të mëdhenj, është e rëndësishme të përcaktoni ku mund të hyjnë dhe ku nuk mund të hyjnë në internet, para se të fillojnë me aktivitetet online.



Hapi nr. 5 – Mësoni fëmijët për sjellje të përgjegjshme dhe të sigurt online

Ruajtja e të dhënave personale

Tregojuni fëmijëve tuaj se **nuk duhet t'ua japin të dhënat e veta personale njerëzve të panjohur në internet** dhe përkujtoni se **duhet t'i përdorin optionet për privatësi në faqet e tyre personale për rrjetëzim social**. Informatat që i lënë aty duhet të jenë private, gjegjësisht të kufizuara për qasje. Mjaf-ton që këto informata të mund t'i shohin vetëm shokët dhe familjet e tyre. Ata nuk do të donin t'i tregojnë informatat që në të ardhmen mund t'u bëhen pengesë në rrugën për në fakultetin ku duan të studiojnë apo punën në cilën duan ta bëjnë. Tregojuni se është **e pandershme të zbulohen të dhënat për shokët dhe familjet e tyre. Kur shpallin fotografi, ato duhet t'i bëjnë private dhe të mos u vendosin tag-e** (etiketa të cilat i emërtojnë të pranishmit në fotografi).

Fëmijët duhet të mbajnë mend se **fjalëkalimet janë vetëm për ta dhe të kenë kujdes asnjëherë të mos e aktivizojnë optionin për të mbajtur mend automatikisht emrin përdorues dhe fjalëkalimin kur e kontrollojnë e-mailin apo kur përdorin programe për bisedë në ndonjë kompjuter publik**.

Takimi i drejtpërdrejtë

Mësoni fëmijët që në jetën reale të mos takohen me personat të cilët i kanë njohur online. Në qoftë se pajtoheni që fëmija juaj të takohet me ndonjë shok që e ka njohur online, më mirë është të shkoni me ta dhe takimi të bëhet në ndonjë vend publik. Adoleshentët të cilët me siguri nuk do të donin të shkojnë me të rritur, duhet të marrin me vete një shok të vetin.

Sjellja online

Për fëmijët është shumë më e lehtë të sillen në mënyrë të pahijshme online, sesa në jetën reale. Në këtë kontribuon edhe mundësia për përdorim të pseudonimeve të cilët i fshehin fajtorët e vërtetë për ndonjë mesazh të keq, kurse mesazhet e tilla, mund të përhapen lehtë dhe shpejt te të gjithë fëmijët e shkollës. Kjo dukuri është e njohur me emrin **sa-jber-dhunë (cyberbullying)**.

Një rregull të cilën fëmijët duhet ta respektojnë thotë: **në qoftë se dikujt nuk do t'i kishe thënë diçka ballë për ballë, mos ia thuaj as nëpërmjet e-mailit, SMS-së, bisedës në internet apo mesazhit instant dhe mos e vendos në faqen e dikujt tjetër**.

Që vet ata të mbrohen nga e-mailat e padëshiruar, fyes ose frikësues, tregojuni se **mund ta përdorin optionin për filtrim të e-maileve të padëshirueshëm** nëpërmjet shërbimit që ua ka mundësuar e-mail adresën e tyre. Më tepër informata për bllokimin e e-mailave nga dërgues të padëshirueshëm mund të gjeni në:

<http://www.crisp.org.mk/bllokim>

Mësoni fëmijët të shpallin përmbajtje me përgjegjësi. Ata duhet t'i shqyrtojnë kushtet për përdorim të serviseve para se të vendosin të shpallin nëpërmjet tyre. Gjithashtu, në qoftë se vërejnë ndonjë përmbajtje të papërshtatshme, në qoftë se ekziston optioni, mund ta shënojnë si të tillë, që ta pamundësojnë që edhe fëmijë të tjerë të hasin në të. Mundësi të tillë, për shembull ka shërbimi YouTube, i cili mundëson vendosje të flamujve në video të papërshtatshme, që më vonë ato të fshihen.

Kontrollimi i vërtetësisë

Përkujtoni fëmijët se **gjithçka që është shpallur në internet, nuk do të thotë se patjetër është e saktë**. Përmbajtjet duhet të shihen me sy kritik, informacionet duhet të vërtetohen edhe prej burimeve të tjera, si dhe të kontrollohet autori i tekstit të cilin planifikojnë ta marrin si bazë për projektin e tyre shkollor apo për ndonjë aktivitet të tyre personal. Mësoni si t'i dallojnë përmbajtjet e besueshme prej atyre të pabesueshme dhe mësoni se kopjimi i teksteve nga ndonjë ueb-sajt mund të jetë plagjiat. Për dallimin e vërtetësisë së ueb-sajteve, në mënyrë të detajuar informohuni këtu:

<http://www.crisp.org.mk/besim>



Si masë më serioze të cilën mund ta ndërmerri për të ofruar siguri për fëmijëve tuaj në internet është përdorimi i softuerëve specialë për filtrim, mbikëqyrje dhe kontroll të prindërve, si dhe përshtatja e opsioneve të gatshme për siguri të sajteve të cilat i përdorin ata. Softuerët e tillë janë shumë të përshtatshëm për kontrollim të aktiviteteve online të fëmijëve më të vegjël, edhe pse disa prej opsioneve që ato i përmbajnë, mund të zbatohen edhe tek adoleshentët. Fëmijët dhe adoleshentët edhe vetë duhet të mësojnë si të jenë të sigurt online, sepse është e pamundur që prindërit dhe mësuesit ta mbikëqyrin çdo lëvizje të tyre online.

Ekzistojnë disa mënyra për kontrollim të aktiviteteve të fëmijëve gjersa ata janë online. Në qoftë se vetëm doni të dini se cilat faqe i kanë vizituar fëmijët tuaj, shikojeni listën e faqeve në menynë History (historia). Nga ana tjetër, mund të përdorni softuer për filtrim të përmbajtjeve të pahijshme, ose të paktën ta aktivizoni opcionin për kërkim të sigurt në kuadër të kërkuesit të cilin e përdorni. Për shembull, prej faqes kryesore të kërkuesit Google, klikoni në linkun Preferences dhe pastaj përzgjidhni një prej opsioneve të ofruara në pjesën SafeSearch Filtering. Në këtë mënyrë do të pengoni që përmbajtjet eksplicite gjatë kërkimit të paraqiten para syve të fëmijëve tuaj.

Softuerët e mëposhtëm mund të përdoren për më shumë qëllime, përfshijnë shumë opsione për filtrim, mbikëqyrje dhe kufizim të përmbajtjeve dhe aktiviteteve online. Që të vendosni kontroll të prindërve mbi aktivitetet online të fëmijëve tuaj, përzgjidhni atë që ju përgjigjet më shumë.

1. Crawler Parental Control është një prej softuerëve të rrallë për kontroll të prindërve që jepet falas, e është gjithëpërfshirës dhe plotësisht funksional. Menjëherë pas instalimit jepet fjalëkalimi i administratorit, që prindit i mundëson t'i bëjë përshtatjet që dëshiron për secilin përdorues të kompjuterit veç e veç. Softueri mundëson kontrollim të kohës që përdoruesi e kalon online, si dhe kufizim të kohës që ai mund ta kalojë në përgjithësi në kompjuter. Mund të vendosen ueb-sajte të caktuara të cilat përdoruesi nuk lejohet t'i vizitojë, të tjera që janë të lejueshme, si dhe fjalë, të cilat, në qoftë se gjenden në ndonjë ueb-faqe, do ta bëjnë të pamundur futjen në të.

Crawler Parental Control mundëson dhe kufizim të qasjes së përdoruesve në dosje (*folder*) të caktuara, apo dhe në disqe të tëra të kompjuterit. Ky kufizim mund të jetë i tërësishëm ose mund të vlejë për periudha të caktuara të javës dhe ditës, kurse ekziston edhe mundësia për përcaktimin e numrit të lejuar të orëve që përdoruesit kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë gjatë muajit, javës apo ditës. Gjithsesi mund të bllokohen edhe programe të caktuara si dhe të ndalohet qasja në lokacione të caktuara të sistemit, me qëllim që të pengohen ndryshime që cilat mund ta bëjnë të pamundur punën normale të sistemit.

Për gjithë këtë, ju si prind, poqese doni, mund të merrni raporte.

Linku për shkarkim:

<http://www.crawlerparental.com>



2. **Glubble** është një mjet mjaft popullor familjar që shfrytëzohet si shtojcë për shfletuesin e internetit Mozilla Firefox. Edhe pse përdorimi i tij është i kufizuar vetëm për këtë shfletues, ai mund të përdoret në të gjitha sistemet operative.

Me ndihmën e kësaj shtojce, shfletuesi ndahet në dy pjesë, ku njërin e përdorin dhe administratorin prindërit, kurse e dyta u dedikohet fëmijëve. Për çdo fëmijë mund të përpilohet profil i veçantë që do të mundësojë aktivitete të përshtatshme online për moshën e tij.

Në fillim, prindi jep fjalëkalimin e administratorit, falë së cilës mund t'i bëjë përshtatjet e dëshiruara, si dhe ta shfrytëzojë shfletuesin për nevojat e veta. Në momentin kur ndonjëri prej fëmijëve do të dojë ta shfrytëzojë shfletuesin, vetëm e përzgjedh profilin e vet. Do të fitojë mjedis krejtësisht të ri, nëpërmjet të cilit do të mund të navigojë në listën e definuar më parë të ueb-sajteve edukative dhe argëtuese, të kërkojë të shohë sajte të reja, sajte më interesante vetëm me një klik t'i vendosë në koleksionin e sajteve të pëlqyera (*favorites*) apo të lerë mesazhe për anëtarët e tjerë të familjes. Mundësitë për kërkim janë të kufizuara në termat e sigurta. Përbajtjet e përzgjedhura deri tani, që janë pjesë e Glubble, janë në anglisht, por ju thjesht mund t'i shtoni edhe ato në shqip. Është planifikuar që deri në fund të vitit 2008, interfejsi i programit të jetë edhe në shumë gjuhë të tjera.

Glubble në formën e vet themelore është falas për shkarkim dhe përdorim, ndërsa është planifikuar dhe zhvillim i versionit të pasuruar komercial.

Linku për shkarkim:
<http://glubble.com>

3. **K9 Web Protection** është vegël pa pagesë për filtrim të ueb-përmbajtjeve dhe vendosje të kontrollit të prindërve mbi aktivitetet e fëmijëve gjersa ata janë online. Për përdorimin e tij ju duhet licencë, të cilën mund ta merrni pa pagesë, nëpërmjet e-mailit, në qoftë se e kaloni procedurën e regjistrimit.

Ky softuer është specifik sepse konfigurohet prej vetë shfletuesit të internetit. Kjo do të thotë se ai e anashkalon problemin e disa programeve të cilat funksionojnë vetëm për shfletues të caktuar të internetit. Edhe një karakteristikë tjetër pozitive është përkrahja për versionet e fundit të Windows sistemeve operative, duke përfshirë edhe Windows Vista, kurse risia e fundit është përshtatja e tij për sistemet Macintosh.

Çka mund të rregulloni me sistemet K9 Web Protection? – Me këtë softuer të vogël, para së gjithash, mund ta përcaktoni nivelin e mbrojtjes për profilin e dëshiruar përdorues të sistemit, keqpërdorimin e të cilit do ta pamundësoni nëpërmjet fjalëkalimit. Mund të zgjedhni midis disa niveleve të ofruara për mbrojtje të cilat përfshijnë ndalim të vizitës së llojeve të caktuara të përmbajtjeve apo listën e përmbajtjeve të ndaluara ta përshtatni vetë ju. Mandej, mund të caktoni periudha brenda ditës kur do ta ndaloni përdorimin e shfletuesit, si dhe periudha kur do ta lejoni. Ueb-sajte të caktuara mund të jenë të ndaluara, kurse disa të tjera mund të jenë të lejuara gjithmonë. Ndalimi mund të caktohet edhe në bazë të fjalëve kyçe, si dhe të përzgjidhet mënyra për raportim dhe dënim në qoftë se bëhet përpjekje për futje në ndonjërin nga përmbajtjet e ndaluara.

Sigurisht, një prej opsioneve më të rëndësishme që e mundëson ky softuer është sistemi i detajuar për raportim, nëpërmjet të cilit do të fitoni pasqyrë të qartë për aktivitetet online të fëmijës tuaj.

Linku për shkarkim:
<http://www1.k9webprotection.com>




4. Ndoshta nuk do të keni nevojë për softuer shtesë për kontroll të prindërve në qoftë se e shfrytëzoni versionin aktual të sistemit operativ Windows – **Windows Vista**. Tani, falë mjetit **Parental Controls** i cili gjendet në **Control Panel**, prindërit mund të krijojnë profile të veçanta shfrytëzuesish për fëmijët e tyre dhe ato të jenë të përshtatshme me moshën dhe interesat personale të tyre. Në ndërkohë, me rritjen e fëmijës, profilet përdoruese për shfrytëzim të kompjuterit mund të ndryshojnë.

Prej këtij vendi qendror, mund të konfiguroni kontrollin të prindërve për kompjuterin tuaj. Në qoftë se kontrolli i prindërve është i çkyçur, së pari aktivizojeni, e pastaj fëmijës tuaj do të mund t’ia kufizoni përdorimin e aplikacioneve të caktuara, luarjen e lojrave, ueb-sajtet që mund t’i vizitojë dhe kohën që i lejohet brenda ditës për të gjitha këto aktivitete.

Parental Controls është vegël e integruar në Windows Vista, kështu që nuk ka nevojë për shkarkim plotësues dhe për instalim, edhe pse vetë sistemi operativ nuk është pa pagesë. Për shkak se bëhet fjalë për prodhim të Microsoft-it, nënkuptohet se kufizimi i ueb-aktiviteteve ka të bëjë me shfletuesin Internet Explorer. Kjo mundësi mund të tejkalohet me ndalim të shfrytëzimit të aplikacioneve të tjera.

5. Shfrytëzuesit e versionit të fundit sistemeve Mac OS X – **Leopard** mund ta përdorin veglën për kontroll të prindërve që vjen me vetë sistemin. Opcionet e ofruara për përshtatje janë standarde dhe mundësojnë qasje të kufizuara në ueb-sajta të caktuara, kufizim kohor, si dhe mbikqyrje të të gjithave aktiviteteve online të fëmijës tuaj: ueb-faqet e vizituara, aplikacionet e përdorura dhe njerëzit me të cilët ai ka komunikuar nëpërmjet dhomave për bisedë.

6. Ndërsa shfrytëzuesit e sistemeve operative Linux me siguri do të dëshirojnë t’i shfrytëzojnë shtojcat për Mozilla Firefox, të cilat gjithsesi janë funksionale edhe për sistemet e tjera. Disa prej tyre janë: Glubble, ProCon dhe LeechBlock. **ProCon** mundëson filtrim të ueb-sajteve me përmbajtje të padëshiruar për fëmijët ose qasje vetëm në ueb-lokacione të caktuara që janë të lejuara. Ndërsa, **LeechBlock** mundëson filtrim gjithëpërfshirës të ueb-lokacioneve të ndryshme, shënim të përmbajtjeve të padëshiruara nga ana e shfrytëzuesit, si dhe kufizim kohor për të vizituar ueb-sajta të caktuara. Të gjitha këto vegla mund t’i shtohen shfletuesit nëpërmjet opcionit për zgjerim me shtesa të reja.



Softuer alternativ për kontroll të prindërve (falas dhe komercial)

Safe Chat Universal Messenger

përshkrim: bashkon më shumë programe për komunikim online, i bllokoi programet e tjera të këtij lloji, duke i përfshirë edhe programet për komunikim online që janë të bazuara në ueb, dhe përcakton se me kë mund të komunikojnë fëmijët, sa kohë, si dhe cilat fjalë nuk mund t'i përdorin gjatë komunikimit

adresa: <http://www.zihtec.com>

licenca: periudha e testimit - 14 ditë, çmimi: \$34.95

Golden Eye

përshkrim: softuer i fuqishëm për spiunim dhe për mbikqyrje të të gjitha aktiviteteve të kompjuterit: vendosjes së fjalëkalimeve dhe të dhënave të tjera, ueb-faqeve të vizituara, aplikacioneve të shfrytëzuara dhe të gjitha këto të dokumentuara me fotografi të bëra në momentin e përdorimit

adresa: <http://www.monitoring-spy-software.com>

licenca: periudha e testimit - 15 ditë, çmimi: \$29,95

Safe Eyes

përshkrim: i bashkon të gjitha opsionet e nevojshme për kontroll të prindërve: kufizon qasje në lloje të caktuara të ueb-faqeve dhe programeve, e kufizon kohën për aktivitete të ndryshme në internet, mban shënime për aktivitetet dhe lajmëron për shkeljet në disa mënyra

adresa: <http://www.internetsafety.com>

licenca: \$49,95

Web Watcher

përshkrim: njëri prej softuerëve më të mirë për filtrim në internet, bllokoi të programeve, kufizon kohor dhe mbikqyrje të avancuar të aktiviteteve të fëmijës gjersa e shfrytëzon kompjuterin

adresa: <http://www.webwatchernow.com>

licenca: \$97.30

Net Nanny

përshkrim: softuer për kontroll të prindërve me karakteristika filtruese, mundësi për bllokim të programeve për bisedë dhe programeve për ndarje të fajlave, grupeve (newsgroups) dhe mundësi më të vogla për mbikqyrje të aktiviteteve

adresa: <http://www.netnanny.com>

licenca: periudha e testimit - 14 ditë çmimi: \$39.99 në vit

Cyber Patrol

përshkrim: program për kontroll të prindërve me përzgjedhje të pasur të opsioneve për filtrim, bllokim të programeve, menaxhim të kohës së lejuar dhe mbikqyrje, u dedikohet shfrytëzuesve më të avancuar

adresa: <http://www.cyberpatrol.com>

licenca: licenca: periudha e testimit - 14 ditë çmimi: \$39.95 në vit

We-Blocker

përshkrim: bllokues i ueb-përmbajtjeve të padëshirueshme me funksione themelore

adresa: <http://www.safefamilies.org>

licenca: falas

FreeShield

përshkrim: vegël falas për detektim dhe mënjanim të përmbajtjeve për të rritur

adresa: <http://www.freeshield.com>

licenca: falas

ChatShield

përshkrim: bllokues falas i kontakteve të padëshiruara të Windows Live Messenger, që kufizon kontakt me fëmijë deri në moshë të caktuar

adresa: <http://www.chatshield.com>

licenca: falas

File Sharing Sentinel

përshkrim: i bllokoi programet peer-to-peer dhe i mbron fëmijët nga shfaqja e pornografisë dhe shfrytëzimi i përmbajtjeve të mbrojtura, kurse kompjuterin e mbron prej spyware

adresa: <http://www.akidthaine.com>

licenca: falas

KidZui

përshkrim: shfletues për fëmijë të moshës 3-12 vjet.

Fëmijëve ju mundëson përjetim të përvojave multimediale në internet, kurse prindërve u mundëson kontroll të mirë

adresa: <http://www.kidzui.com>

licenca: falas

Parental control bar

përshkrim: mundëson filtrim të ueb-faqeve të padëshiruara dhe ofron kalim të thjeshtë prej regjimit të prindërve, të mbrojtur me fjalëkalim, në regjimin për fëmijë

adresa: <http://www.parentalcontrolbar.org>

licenca: falas

Softueri për kontroll të prindërve është mënyrë e shkëlqyer për kontrollim, kufizim dhe mbikqyrje të aktiviteteve të fëmijëve gjersa ata janë në internet. Por, siguria e tyre nuk është e vetmja gjë që mund të vihet në pyetje si rezultat i shfrytëzimit jopërkates të internetit. Siguria e gjithë familjes, madje dhe e kompjuterit, të cilin e shfrytëzoni të gjithë, gjithashtu mund të rrezikohet. Prandaj, duhet të bisedoni me fëmijët tuaj dhe t'u jepni këshilla të dobishme, si dhe të mësoni se si të kujdeseni për kompjuterin tuaj që ta siguron funksionimin e tij normal. Për këtë temë, në mënyrë më të detajuar mund të informoheni në:

<http://www.crisp.org.mk/resurse>



7

Hapi nr. 7 – Rregullorja familjare

Përpiloni një rregullore familjare apo shfrytëzoheni atë që është në faqen e fundit. Pasi ta nënshkruajni të gjithë anëtarët e familjes, vendoseni në mur, në afërsi të kompjuterit.

Udhëzime për përdorim të internetit sipas moshës së fëmijëve

deri në 10 vjet

Fëmijët në këtë moshë duhet t'i mbikqyrni që të jeni të sigurt se nuk hasin në përmbajtje jopërkatese. Prindërit, fëmijët e të cilëve janë në moshë deri në 10 vjet, duhet të shfrytëzojnë vegla për përdorim të sigurt të internetit që ta kufizojnë qasjen në përmbajtje, ueb-sajte dhe aktivitete të caktuara, si dhe të marrin pjesë aktive në aktivitete të fëmijës në internet.

11-14 vjet

Fëmijët në këtë moshë janë më të shkathtë kur e përdorin internetin. Sidoftë, atyre dhe më tej u nevojitet mbikqyrje që të sigurohet mbrojtja e tyre nga përmbajtjet jo përkatëse. Veglat për përdorim të sigurt të internetit duhet të shfrytëzohen për

kufizim të qasjes në përmbajtje dhe ueb-faqe të caktuara, si dhe për marrje të raporteve për aktivitete në internet të fëmijëve gjersa ata kanë qenë online. Gjithashtu, fëmijët në këtë moshë, duhet të kuptojnë se informatat private nuk duhet të jepen në internet.

15-18 vjet

Fëmijët në këtë moshë pothuajse nuk duhet të kenë kufizime në aspekt të përmbajtjeve, ueb-sajteve dhe të aktiviteteve. Adoleshentët janë mjaft të shkathtë në përdorimin e internetit. Megjithatë, prindërit, edhe atyre duhet t'u caktojnë disa udhëzime themelore për siguri. Duhet t'i kenë në disponim që t'i kuptojnë mesazhet e papërshtatshme që i kanë pranuar fëmijët e tyre dhe t'u tregojnë se si t'i evitojnë situatat jo të sigurta. Nuk është keq t'i përkujtoni fëmijët se cilat të dhëna personale nuk duhet të jepen nëpërmjet internetit.

Këshilla plotësuese për mbrojtjen e fëmijëve tuaj në internet sipas moshës së tyre mund të merrni këtu: <http://www.crisp.org.mk/udhezime>.



Për arsimtarët

Këshilla për shfrytëzim të sigurt të internetit: zvogëlimi i rreziqeve në klasë

Udhëzimet e mëposhtme paraqesin disa strategji themelore që do t'u ndihmojnë arsimtarëve dhe profesorëve që t'i zvogëlojnë rreziqet që lidhen me aktivitetet e nxënësve në internet:

1. Mësoni gjithçka që mundni për internetin
2. Zbuloni çfarë shprehish të internetit kanë nxënësit – ku, sa shpesh dhe sa gjatë ata janë online
3. Përpiquni që monitorët në klasë të jenë gjithmonë të dukshëm për ju.
4. Informoni prindërit – dërgojuni letra, thirrni për bisedë dhe organizoni punëtori edukative për të interesuarit.
5. Njihuni me politikën për përdorim të internetit që zbatohet në shkollën ku jepni mësim, në qoftë se ajo ekziston.
6. Krijoni marrëveshje të ndërsjellë për shfrytëzimin e internetit në klasë – përcaktoni se cilat aktivitete janë të lejuara për nxënësit, e cilat jo, cilat sajte mund t'i vizitojnë e cilat jo, dhe përfshini edhe ata në përpilimin e marrëveshjes.
7. Krijoni listë të linqeve dhe resurseve të rekomanduara për detyrat shkollore dhe ato shtëpiake.
8. Mësoni fëmijët që të mos i japin të dhënat e tyre personale në internet.
9. Nxitni diskutime të hapura me nxënësit më të mëdhenj për sjelljen e tyre në internet.
10. Paraqitni çdo lloj përmbajtje apo aktivitet online, për të cilat dyshoni se janë joligjore.

Më tepër për rolin tuaj në mbrojtjen e fëmijëve gjersa përdorin internet në shkollë, për rregullat që duhet t'i kenë parasysh në përputhje me moshën e tyre, si dhe ide dhe resurse që mund t'i përdorni në procesin arsimor do të gjeni në: <http://www.crisp.org.mk/mesimdhenes>.

Fotografi nga edukimet për shfrytëzim të sigurt të internetit të mbajtura në Ohër



Rregullore familjare për internet

- ➔ 1. Nuk do të shikoj, shkarkoj ose kopjoj material të papërshtatshëm apo të dyshimtë. Në qoftë se për diçka nuk jam i sigurt se a është OK, së pari do të pyes. Në qoftë se shoh online, diçka të papërshtatshme që do të më shqetësojë, do t'u tregoj prindërve të mi. Nuk do të ruaj fshehtësi online prej prindërve të mi.
- ➔ 2. Nuk do t'i jap informacionet e mia personale (emrin e vërtetë, moshën, adresën, numrin e telefonit, emrin e shkollës, fjalëkalimin dhe pamjen time) askujt online, dhe as që do të mbush formularë online për vetveten pa lejen e prindërve apo të kujdestarëve të mi. Asnjëherë nuk do të dërgoj fotografi pa marrë leje speciale.
- ➔ 3. Nuk do të merrem vesh që të takohem drejtpërdrejt, me dikë me të cilin jam njohur në internet, pa marrë leje nga prindërit. Në qoftë se marr leje për takim, pajtohem të shkoj me ndonjë të rritur, edhe atë në vend publik. Nuk do të merrem vesh të bisedoj në telefon me dikë që e kam njohur online pa lejen e prindërve. E kam të qartë se njerëzit mund të mos jenë ata të cilët paraqiten online.
- ➔ 4. Gjithmonë do të sillem me edukatë kur do të komunikoj me të tjerë, nuk do të përdor gjuhë të pistë, nuk do t'i ofendoj njerëzit dhe nuk do të sillem në mënyrë të pahijshme. Do ta respektoj privatësinë e miqve dhe të familjes sime.
- ➔ 5. Nuk do të blej prodhime apo shërbime online pa miratimin dhe pa ndihmën e prindërve të mi.
- ➔ 6. Nuk do t'u përgjigjem mesazheve e-mail apo mesazheve instant të cilat i kam marrë prej ndonjë të panjohuri.
- ➔ 7. Do t'i respektoj rregullat e prindërve apo kujdestarëve të mi në lidhje me periudhat kur mund ta shfrytëzosh kompjuterin, kufizimet kohore për shfrytëzim, si dhe cilat lojëra dhe programe mund t'i shfrytëzosh, e cilat jo.
- ➔ 8. Në qoftë se kam më pak se 16 vjet, nuk do t'i përdori dhomat për bisedë (chat rooms), por vetëm programe për mesazhe instant dhe do të komunikoj vetëm me ato kontakte që do të m'i lejojnë prindërit apo kujdestarët e mi.
- ➔ 9. Nuk do të instaloj programe softuerike pa marrë leje. E kam të qartë se programet për shkëmbim të fajlave nëpërmjet peer-to-peer si Kazaa, Limewire apo BearShare nuk janë të lejuara.
- ➔ 10. Nuk do ta përdor kompjuterin që të bëj punë joligjore, që do të thotë se nuk do të marr softuerë, muzikë apo filma në mënyrë joligjore.
- ➔ 11. Këto rregulla do të vlejnin kudo që të jem (në shtëpi, te shoku apo shoqja, në shkollë apo në klube interneti)
- ➔ 12. E kam të qartë se shkelja e këtyre rregullave mund të rezultojë me marrje të kompjuterit dhe jam i gatshëm t'i mbaj pasojat.

Pajtohem me rregullat e mësipërme.

Nënshkrimi i fëmijëve:

Nënshkrimi i prindërve:



Interneti është vendi ku mund të gjenden shumë informata të dobishme, përmbajtje interesante dhe argëtuese, si dhe vend që ofron shumë mundësi për komunikim që mund t'i shfrytëzojnë fëmijët dhe adoleshentët, por edhe të rriturit. Ai është vend ku mund të fitohen dhe të shtohen njohuritë, të përforcohen kontaktet dhe të hulumtohen gjëra të reja. Edhe përkundër këtyre mundësive enorme të këtij mediumi të ri, ekzistojnë dhe rreziqe të shumta prej të cilave pësojnë fëmijët dhe adoleshentët, si rezultat i naivitetit dhe papërvojës së tyre. Prandaj, është e nevojshme të njihen disa rregulla themelore të cilat duhet t'i respektojnë derisa e shfrytëzojnë internetin, mirëpo njohuri përkatëse për mbrojtje të fëmijëve në internet duhet të marrin dhe të rriturit, një pjesë e madhe e të cilëve ende e konsiderojnë internetin si medium të panjohur.

Projekti CRISP (Children's Rights on the internet – Safe and Protected) apo Mbrojtja dhe siguria e fëmijëve dhe të drejtat e tyre në internet, merret pikërisht me këtë temë. Ka filluar të realizohet në tetor të vitit të kaluar, por pjesa më e madhe e aktiviteteve u realizuan këtë vit, ndërsa do të përfundojë në tetor të këtij viti.

Në kuadër të projektit, së pari u botuan tri lloje publikimesh në gjuhën maqedonase dhe shqipe të cilat pastaj u shpërndanë nëpër shkollat e Maqedonisë. Në fillim është botuar Broshura për mbrojtje të të dhënave personale dhe të privatësisë në internet në bashkëpunim me Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale, e më vonë janë botuar poster i cili e përmban Kartën për të drejtat e fëmijëve në internet dhe fletushka për përdorim të internetit me shkathtësi. Në të njëjtën kohë është zhvilluar edhe ueb-sajti zyrtar i projektit, edhe atë në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Në fazën e dytë është organizuar seminar edukativ ku morën pjesë 34 pjesëmarrës nga 11 OJQ nga Maqedonia dhe 8 përfaqësues në rolin e edukatorëve. Në këtë seminar treditor, pjesëmarrësit u trajnuan për realizim të edukimeve për përdorim të sigurt të internetit nga fëmijët dhe adoleshentët, e të dedikuara, përveç për ta, edhe për arsimtarët dhe prindërit.

Eduktorët ishin përfaqësues të këtyre OJQ: Asocioni për iniciativë demokratike (Gostivar), Shoqata humanitare dhe e bamirësisë e romëve "PHURT" (Dellçevë), Fondacioni për zhvillim të bashkësisë lokale (Shtip), Shoqata humanitare "Nëna" (Kumanovë), Qendra kulturore e të rinjve (Manastir), Qendra për iniciativë qytetare (Prilep), Hapni dritaret (Shkup), Këshilli rinor i Ohrit (Ohër), Forumi edukativ rinor (Shkup), Këshilli për parandalim të delikucencës të miturit (Kavadar) dhe Ambasada e parë e fëmijëve në botë - Megjashi (Shkup).


Në fazën e tretë u realizuan edukime në 28 shkolla të Maqedonisë. Në to u përfshin 3144 nxënës të shkollave tetëvjeçare dhe të mesme, 411 arsimtarë dhe 421 prindër. Edukimet përfshinin përcjellje të përmbajtjeve për përdorim të sigurt të internetit

nëpërmjet prezantimit, ndarje të pakove me materiale edukuese, diskutim interaktiv dhe plotësim të pyetësorëve për vlerësim të shprehive të tyre në internet, si dhe për njohuritë e tyre të përgjithshme për internetin dhe rreziqet e mundshme nga përdorimi jo i drejtë i tij.

Në fazën përfundimtare të këtij projekti bëhet analiza e rezultateve të pyetësorëve dhe shihen ndryshimet që kanë ndodhur në mendimet, shprehitë dhe vetëdijen e të anketuarve, si rezultat i dallimeve në përgjigjet e tyre në të dy rrethet e plotësimit të pyetësorëve të paraparë në procesin e vlerësimit, njëri i realizuar në

maj-qershor, e tjetri në shtator. Një prej aktiviteteve përfundimtare të projektit është edhe ky doracak për arsimtarët dhe prindërit, por, nëpërmjet të cilit dhe vetë fëmijët mund ta fitojnë edukimin e domosdoshëm për siguri në internet.

Projekti CRISP zbatohet në bashkëpunim me Drejtorinë për mbrojtje të të dhënave personale dhe Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi, kurse financiarisht është mbështetur nga BE-ja.





Sigurt në internet

(<http://www.crisp.org.mk>,
<http://www.internetisigurt.org.mk>)

Ky ueb-sajt është krijuar që të kontribuojë për siguri më të madhe dhe mbrojtje të të drejtave dhe të privatësisë së fëmijëve në internet. Sajti është pjesë e projektit Mbrojtja dhe siguria e fëmijëve dhe të drejtat e tyre në internet (Children's Rights on the internet – Safe and Protected) apo shkurtimisht CRISP të cilin e zbaton Fondacioni Metamorfozis me ndihmë financiare nga Bashkimi Evropian.

Ueb-sajte të dobishme për më shumë informacione

- ➔ <http://parental-control-software.topchoicereviews.com>
Recenzim për softuerin më të mirë komercial për kontroll të prindërve për vitin 2008.
- ➔ <http://www.netsmartz.org>
Pjesë e qendrës nacionale për fëmijë të humbur dhe të keqpërdorur dhe mbrojtje të tyre, që përfshin edukim për përdorim të sigurt të internetit, dedikuar të gjitha kategorive të moshave.
- ➔ <http://www.kidsmart.org.uk>
Ueb-sajt me program praktik për siguri në internet, dedikuar për shkolla, të rinjë, prindër dhe agjenci.
- ➔ <http://www.saferinternet.org>
Insafe është rrjeti i nyjeve nacionale që e koordinojnë vetëdijen për siguri në internet në Evropë.
- ➔ <http://teachtoday.eu>
Ueb-sajt i shkëlqyeshëm shumëgjuhësh që siguron resurse për arsimtarët në temën: përdorimi i përgjegjshëm dhe i sigurt i teknologjive të reja të komunikimit.

Ueb-sajti përmban shumë gjëra të dobishme për fëmijët dhe adoleshentët, prindërit dhe arsimtarët e tyre. Këtu do të gjeni shumë këshilla dhe udhëzime se si të kënaqeni në mënyrë të sigurtë në begatitë e internetit, informata të përgjithshme për internetin si medium, mundësitë që i ofron, rreziqet që i bart me vete dhe mënyrat se si të mbrohemi prej tyre.

- ➔ <http://www.childnet.com>
Organizatë joprofitabile e cila bashkëpunon me organizata të tjera që të ndihmojë që interneti të bëhet vend i shkëlqyeshëm dhe i sigurt për fëmijët
- ➔ <http://www.getnetwise.org>
Servis publik që kontribuon që shfrytëzuesit e internetit të kenë përvoja të sigurta, konstruktive, edukative dhe argëtuese online.
- ➔ <http://www.media-awareness.ca>
Resurse edukative për mediumet dhe internetin
- ➔ <http://www.cybersafetynet.com>
Informacione dhe vegla që do t'u ndihmojnë prindërve dhe fëmijëve të tyre të jenë të sigurt kur janë online.
- ➔ <http://www.besafeonline.org>
Informata për të gjitha format e njohura të komunikimit online, rreziqet dhe problemet që paraqiten gjatë shfrytëzimit të tyre dhe mënyra për evitim të tyre si dhe ballafaqim me to.
- ➔ <http://www.cybersmartkids.com.au>
Qendër edukative resurcesh për përdorim të sigurt të teknologjive të reja.



Ky dokument është krijuar me ndihmën financiare të Unionit Evropian. Për përmbajtjen e këtij dokumenti përgjigjet vetëm Fondacioni Metamorfozis dhe e njëjta nuk mund të unifkohet me qëndrimet e Unionit Evropian.

Autori i tekstit: Irina Shumadieva

Përkthimi: Jordana Shemko-Georgievska, Vermilion translations

Lekturoi: Miftar Abdiu

Përpunimi grafik: **FETSERIQUE** DESIGN

Autori dhe Fondacioni Metamorfozis i mbajnë të drejtat e autorëve për tekstet që janë botuar në këtë manual. (Botimi në gjuhën maqedonase: shtator 2008).



Përmbajtjet publikohen në formë digjitale nën licencën e Creative Commons: Trego një burim-Në mënyrë jokomerciale-Pa vepra të përshtatura. 2.5 Maqedonia <http://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/2.5/mk>



Metamorfozis është një fondacion i pavarur, jopartiak dhe joprofitabil me seli në Shkup, Republika e Maqedonisë. Qëllimet kryesore të saj janë zhvillimi i demokracisë dhe prosperitetit nëpërmjet promovimit të ekonomisë të bazuar në njohuri dhe shoqëri të informacionit.

Adresa e kontaktit:
Fondacioni Metamorfozis
rr. „Naum Naumovski – Borçe“ 88-a
1000 Shkup, Maqedoni
telefon: +389 2 3109 325
faks: +389 2 3225 206
e-posta: info@metamorphosis.org.mk
ueb-faqja: www.metamorphosis.org.mk

CIP – Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје
004.738.5-053.2(035)
Šumadieva, Irina
Sigurtë në internet / [autor i tekstit Irina Shumadieva ; përkthimi: Jordana Shemko-Georgievska]. - Skopje : Metamorfozis, 2008.
- 16 str. : ilustr. ; 30 cm. - (Doracak për TIK / Metamorfozis ; nr. 5)
ISBN 978-9989-2792-6-3
I. Shumadieva, Irina види Šumadieva, Irina
a) Интернет – Деца корисници– Безбедност – Прирачници
COBISS.MK-ID 73859082